

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "Il Baka-Ro" SH.P.K.

Sot, me datë 09/06/2023,

Z.Alessandro De Pieri, shtetas Italian , i biri i **Silvio De Pieri**, lindur më 08/08/1962, në Valdobbiadene (TV)/Itali, banues në Via San Marco, N. 141/E/2 Caerano Di San Marco / Itali, e mbajtës i ID me nr . CA91581LB , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeluan një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Il Baka-Ro" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**Il Baka-Ro**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: *Diga e Liqenit, kompleksi "Lake View", struktura D, njesia tregtare N-01.*

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI



Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Bar, kafë, restorant, catering, vinoteke,
- Import vere dhe djathi etj.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100,000 (Njëqind mijë) Leke dhe është i ndarë në 2 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z.Alessandro De Pieri lindur me 08/08/1962**, zoteron 1 kuotë, me 70% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 70,000 (Shtatedhjetë mijë) Leke të kapitalit themeltar.
- **Z. Aurel Nezhaj lindur me 23/10/1986**, zoteron 1 kuote, me 30% te kapitalit themeltar, me 1 (nje) pjese me vlere 30,000 (Tridhjetë mijë) Leke te kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi administrativ i shoqërisë është Administratori I shoqërisë :
- **Z.Alessandro De Pieri** i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, nga 09/06/2023 – 09/06/2028, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7



LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë.

ORTAKET E SHOQËRISË

Z. Alessandro De Pieri

Alessandro De Pieri



Z. Aurel Nezhaj

Aurel Nezhaj

